



INSPEKTORATI POLICOR I KOSOVËS

Përmbledhje mujore e aktiviteteve nga IPK – shkurt 2025

Menaxhimi i ankesave

IPK gjatë muajit shkurt 2025 ka pranuar dhe ka menaxhuar me 144 ankesa. Prej tyre 110 ankesa që janë klasifikuar si shkelje disiplinore dhe janë përcjellë për t'u trajtuar në Drejtorinë për hetime të brendshme dhe verifikim të së kaluarës në Policinë e Kosovës, kurse 34 nga to janë përcjellë në Departamentin e Hetimeve në IPK më dyshimin për veprimtari penale .

	Gjithsej	Për javë	Për ditë
Numri i ankesave	144	36	5

Aktivitete në fushën e hetimeve

Bazuar në mandatin e paraparë me legjislacionin në fuqi, IPK kryen hetime penale dhe disiplinore ndaj punonjësve të Policisë. Gjatë muajit shkurt 2025 Departamenti i Hetimeve në IPK ka pranuar 34 raste për hetim penal dhe në kuadër të autorizimeve ligjore ka dhënë rekomandimin për suspendim në interes të hetimit për 3 punonjës të Policisë së Kosovës.

Aktivitetet e këtij Departamenti janë shprehur në mënyrë tabelore si në vijim:

Indikatori (numri)	Të dhëna për muajin shkurt 2025
Kallëzime penale të parashtruara në Prokurorinë e Shtetit	7
Raporte të veçanta të parashtruara në Prokurorinë e Shtetit	1
Raporte informuese të parashtruara në Prokurorinë e Shtetit	5
Raste të proceduara në DHB, DPP-PK dhe Arkiv-IPK	27
Raste të bashkëngjitura në rastet paraprake	0
Raste të mbetura në nivel informate	2

Aktivitete në fushën e inspektimit

Objekt i veprimtarisë së IPK-së është inspektimi i strukturave e funksioneve në PK, për të siguruar llogaridhënie, efektivitet e efikasitet në zbatueshmërinë e ligjeve, akteve nënligjore e procedurave standarde operuese. Departamenti i Inspektimit në përmbushje të mandatit ushtron mbikëqyrje të vazhdueshme policore përmes inspektimeve.

Gjatë muajit shkurt 2025 inspektorët e IPK-së kanë qenë të angazhuar në këto inspektime:

Fusha e inspektimit	Lloji	Statusi
Menaxhimi i punësimit dytësor në Stacionin Policor- Podujevë	Jashtëzakonshëm	Final
Menaxhimi i punësimit dytësor në SPMK - Gjilan	Jashtëzakonshëm	Në proces